



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më 31.05.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data: 31.05.2023

Drejtuar: *Operatorit ekonomik* “BENAKS - 94” shpk me Nipt J73804663H, me adresë: Pogradec dhe me administrator z. Besnik Ibi.

Procedura e prokurimit/lotit: “Proçedurë e Hapur”-“pune” -“elektronike”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-62163-03-10-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rehabilitim i Lumit të Çërravës”.

Fondi limit: **12 499 950 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **3 Muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në **çmim X**

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “NIKA”shpk, *Numri i NIPT-t J76705047U*

Vlera: 9 125 235 (nëntë milion e njëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) Lekë pa TVSH .

2. “REJ” shpk , *Numri i NIPT-it J93711608Q*

Vlera : 10 567 665 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

3. “INA”shpk,

Numri i NIPT-it J61814009W

Vlera: 9 125 235 (nëntë milion e njëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) Lekë pa TVSH .

4. “BENAKS - 94” shpk

Numri i NIPT-it J73804663H

Vlera: 12 196 899 (dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH.

5. “ZEQILLARI”shpk,

Numri i NIPT-it L61912024O

Vlera: 10 499 275 (dhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “REJ” shpk , me Nipt J93711608Q , për *arsyet e mëposhtme:*

Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni *i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST.*

.Konkretisht:

-Operatori ekonomik **nuk ka paraqitur Grafikon** e zbatimit të punimeve, për të vërtetuar se do të realizojë punimet e kerkuara brenda afatit kohor të percaktuar dhe të kerkuar nga Autoritetit Kontraktor (AK).

- Operatori ekonomik nuk përmbush piken **2.3.8 të kapacitetit teknik të DST** ,pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi /distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Rëre kuarcore

Për rastin **kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.**

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për rastin konkret , operatori ka paraqitur nje kontrate te lidhur me nje person fizik (PF) “Ermal Gjoza” ,kontrate e cila nuk ka nje objekt te percaktuar qarte dhe nuk verehet nese personi ne fjale eshte prodhues apo distributor. Mgjith nga PF eshte paraqitur nje fature ,i cili ka rolin e blesit nga shitesi “Colorbody” per mall “Dolomit jo i kalcinuar”.

Pra nuk ka paraqitur lidhjen qe ka distributori “Ermal Gjoza”me prodhuesin “Colorbody”, ne rast se ky i fundit eshte prodhues apo jo, sepse sipas kriterit te percaktuar ne DST distributori duhej te jepte dhe te dhena te plota dhe te sakta si: telefon, fax, e-mail, website te prodhuesit, apo lidhjen e distributorit me prodhuesin. Paraqitja vetem e nje fature blerjeje nuk verteton dot lidhjen qe ka distributori me prodhuesin...

Për sa më sipër oferta e operatorit “REJ” shpk është e pavlefshme .

2. "INA" shpk, me Nipt J61814009W për arsyet e mëposhtme:

Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni *i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht:*

- Operatori ekonomik **nuk ka paraqitur Grafikun** e zbatimit të punimeve, për të vërtetuar se do të realizojë punimet e kërkuara brenda afatit kohor të përcaktuar dhe të kërkuar nga Autoritetit Kontraktor (AK).

- Operatori ekonomik nuk përmbush piken **2.3.8 të kapacitetit teknik të DST**, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi /distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Rërë kuarcore

Për rastin **kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.**

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për rastin konkret, operatori ka paraqitur një Autorizim për materiale elektrike nga "LM Elektrik" shpk nën çelësinë e distributorit për materiale elektrike, por nuk ka paraqitur **dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.**

E njëjta situatë është dhe për reren kuarcore, për të cilin operatori ka paraqitur një Autorizim nga "Mat-Edil" shpk për rere kuarcore, por nuk ka paraqitur **dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.**

Për sa më sipër oferta e operatorit "INA" shpk është e pavlefshme .

3. "NIKA" shpk, me Nipt J76705047U për arsyet e mëposhtme:

Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni *i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST.*

Konkretisht:

- Operatori ekonomik nuk përmbush piken **2.3.8 të kapacitetit teknik të DST**, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi /distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Rërë kuarcore

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Per rastin konkret operatori **nuk ka paraqitur asnje lloj dokumentacioni** Autorizim/ kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori **per reren kuarcore.**

Ne DST thuhet: **“Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”**

Gjithashtu dhe per materialet eletrike Operatori ekonomik ska paraqitur ashtu sic duhet Autorizimet e prodhuesit, pasi i ka paraqitur ne gjuhen angleze, nderkohe qe LPP dhe rregullat e prokurimit publik e kane te percaktuar qarte qe dokumentacioni i paraqitur ne gjuhe te huaj duhet te jete i perkthyer dhe i noterizuar. Ashtu sic eshte percaktuar qarte dhe ne DST.

Për sa më sipër oferta e operatorit “NIKA”shpk është e pavlefshme .

4. “ZEQILLARI”shpk, me Nipt L61912024O për arsyet e mëposhtme:

Brenda afatit te kerkuar Operatori ekonomik, i cituar mesiper nuk u paraqit per te dorezuar dokumentacionin fizik prane Autoritetit Kontraktor (AK) , por me kalimin e afatit te kerkuar, KVO-ja eshte loguar ne SPE per te bere rivleresim dhe ka vene re se operatori “ZEQILLARI” shpk ka paraqitur ne SPE nje shkrese me lende : “Kthim pergjigje”, *ku ka cituar arsyet e tij te terheqjes nga oferta.*

Me fjale te tjera, Operatori ekonomik “ZEQILLARI”shpk, me Nipt L61912024O, ka hequr dore nga konkurimi ne kete faze te procedures sepse nuk i ka kapacitetet teknike te mjaftueshme per te zbatuar objektin e prokurimit, pasi makinerite i ka te angazhuara ne nje objekt tjetër.

Per sa me siper ,KVO shprehet se: Pjesemarrja ne proceduren e prokurimit eshte me vullnetin e lire te operatoreve qe kane interes te marrin pjese ne te. Humbja e interesit per kete procedure prokurimi eshte nje e drejte e secilit operator pjesemarres dhe nuk varet nga AK . AK nuk mund te detyroje operoret qe nuk duan te marrin pjese apo e humbasin interesin gjate seciles faze te procedures prokurimit , **prandaj ky operator konsiderohet i skualifikuar,duke gene se ka sjelle shkrese per terheqje nga oferta.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë :*Operatorin ekonomik* “**BENAKS - 94**” shpk me Nipt J73804663H, me adresë: Pogradec dhe me administrator z. Besnik Ibi se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **12 196 899 (dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH** ,është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë: **Bashkisë Pogradec** me adresë: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2 ,sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të procedohet , siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

PERSON I AUTORIZUAR NË USHTRIM
TE KOMPETENCAVE TË DELEGUARA
NËNKRYETAR

Paskalino ZIKO